



BE-ja, PRISHTINA DHE TIRANA DËNOJNË DEKLARATËN E MINISTRES SERBE PËR 'SPASTRIMIN ETNIK' TË KOSOVËS

FAQE 4-5

- Serbia ende nuk është çliruar nga ideologjia gjenocidale e Millosheviqit

- BE-ja duhet ta ndalë politikën anti Kosovë të Serbisë



Bashkimi Evropian (BE), institucionet e Kosovës dhe ato të Shqipërisë e kanë dënuar deklaratën e ministres serbe për Administratë Publike dhe Vetëqeverisje Lokale, Snezhana Paunović, e cila tha se, po të ishte

në vend të ish-presidentit serb Slobodan Millosheviq, në vitin 1998 do ta kishte "spastruar etnikisht Kosovën". Zëdhënësja e Komisionit Evropian, Anitta Hipper, ka theksuar se në Evropë nuk ka vend për retorikë që

arsyeton ose promovon spastrimin etnik, duke theksuar se deklaratat e tilla bien ndesh edhe me zotimet që ka marrë Serbia në kuadër të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve me Kosovën të ndërmjetësuar nga BE-ja

ALBULENA HAXHIU DEKRETON ZEJNULLAH GASHIN KRYEPROKUROR TË SHTETIT

F. 3



SHQIPËRIA DHE MALI I ZI PËRPAROJNË NË NEGOCIATA ME BE-në

F. 2



STATISTIKAT E ASK-SË: RITEN PËRDORUESIT E TELEFONISË MOBILE, BIEN FLUTURIMET NË MAJ

F. 8

SPORT



PËRFUNDOI ME SUKSES KAMPI VEROR I TALENTEVE NGA DIASPORA, FFK-ja MIRËPRITI 135 FUTBOLLISTË DHE FUTBOLLISTE

F. 11

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

SHQIPËRIA DHE MALI I ZI PËRPAROJNË NË NEGOCIATA ME BE-në

PRISHTINË, 14 KORRIK - Mali i Zi ka kaluar një tjetër etapë në negociatat me Bashkimin Evropian, duke mbyllur përkohësisht më shumë se gjysmën e kapitujve negociues. Ndërkaq Shqipëria do të mbyllë për herë të parë kapituj negociues, ndërsa Ukraina dhe Moldavia do të hapin secila nga një grup të ri negociatash. E njohur jozyrtarisht si “Super e marta”, kjo ditë ka shënuar organizimin e numrit më të madh të konferencave ndërqeveritare në më shumë se dy dekada. “Sot po zhvillohet numri më i madh i konferencave ndërqeveritare për anëtarësim që nga viti 2002. Ky është një moment jashtëzakonisht i rëndësishëm në procesin e zgjerimit”, tha ministri irlandez për Çështjet Evropiane, Thomas Byrne, vendi i të cilit mban Presidencën e radhës të Bashkimit Evropian. “Kemi pasur një periudhë me angazhim shumë intensiv dhe të rëndësishëm për zgjerimin, ndërsa këtë ditë e shohim si një moment vërtet të rëndësishëm në këtë proces”, shtoi ai. Mali i Zi do të mbyllë përkohësisht dy kapituj

negociues, duke e çuar në 18 numrin e kapitujve të mbyllur nga gjithsej 33 në procesin e negociatave me BE-në. Shqipëria, e cila konsiderohet vendi i dytë më i avancuar në procesin e zgjerimit, do të mbyllë për herë të parë tre kapituj negociues. “Ky është një moment historik për Shqipërinë, e cila po nis mbylljen e kapitujve negociues. Mali i Zi, që është vendi më i avancuar në procesin e zgjerimit, do të mbyllë sot edhe dy kapituj të tjerë. Prandaj, kjo është një ditë për t’u festuar, por edhe një ditë për të shikuar përpara dhe për të punuar edhe më shumë. Ne kemi mbështetjen e shteteve anëtare, por vetëm nëse vendet kandidatë përmbushin detyrimet e tyre. Pikërisht kësaj duhet t’i kushtojmë vëmendje të veçantë”, tha komisionarja evropiane për Zgjerim, Marta Kos. Javët e fundit institucionet evropiane punuan që në këtë të ashtuquajtur “Super të martë” të mbaheshin pesë konferenca ndërqeveritare. Ato u përpoqën t’i bindnin shtetet anëtare që edhe Serbia ta hapte klasterin 3 të negociatave po këtë ditë, por



nuk u arrit konsensus, pasi për mbajtjen e çdo konference ndërqeveritare kërkohet miratimi unanim i të gjitha shteteve anëtare të BE-së. Irlanda, e cila mban Presidencën e radhës të BE-së deri më 31 dhjetor, tha se do t’i vazhdojë përpjekjet për të arritur një konsensus edhe për Serbinë. “Serbia është vend kandidat për anëtarësim dhe kjo është një çështje për të cilën do të vazhdojmë të diskutojmë me shtetet anëtare. Ka ende punë për t’u bërë, por si ministër irlandez jam i përkushtuar të vazhdojmë

dialogun si me shtetet anëtare, ashtu edhe me Serbinë, për të parë se si mund të ecë përpara procesi i saj i anëtarësimit”, tha Byrne. Kos tha se për të ecur përpara në procesin e anëtarësimit, një vend kandidat duhet t’i përmbushë detyrimet e tij. Ajo tha se Komisioni Evropian duhet t’u argumentojë shteteve anëtare përse propozon hapa të caktuar, siç ishte në këtë rast hapja e klasterit 3 për Serbinë. Megjithatë, sipas saj, vendimi përfundimtar varet nga pajtimi i të gjitha shteteve

anëtare, të cilat duhet të binden se ekzistojnë arsye të mjaftueshme për ta lejuar vendin kandidat ta vazhdojë procesin e anëtarësimit. “Pas prapaktimit të evidentuar në Raportin e Zgjerimit të vitit të kaluar, është shënuar njëfarë përparimi. Megjithatë, mbetet ende shumë punë për t’u bërë, veçanërisht në fushën e sundimit të ligjit. Së fundmi kemi marrë sinjale nga Serbia se është e gatshme të harmonizohet më shumë me orientimet strategjike të Bashkimit Evropian”, tha Kos. Gjatë ditës së martë secili delegacion ka zhvilluar takime të veçanta me përfaqësuesit e BE-së. Shqipëria synon t’i përfundojë negociatat për anëtarësim deri në fund të vitit 2027, ndërsa Irlanda vlerëson se Mali i Zi mund ta mbyllë këtë proces deri në fund të këtij viti. Ndryshe nga vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, Kosova ende nuk e ka statusin e vendit kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Ajo aplikoi për anëtarësim në fund të vitit 2022, por kërkesa e saj ende nuk është shqyrtuar.

JORDANIA THOTË SE RRËZOI DISA RAKETA IRANIANE QË SYNONIN NJË BAZË AMERIKANE

AMAN, 14 KORRIK - Qeveria e Jordanisë tha se ka rrëzuar katër raketa balistike iraniane që synonin një bazë ushtarake amerikane në territorin e saj. Sulmi ndodhi pasi Garda Revolucionare Islamike e Iranit (IRGC) i bëri thirrje Jordanisë që t’i mbyllë bazat amerikane në vend. Mediet shtetërore jordaneze, duke cituar një deklaratë të qeverisë, thanë se raketat u rrëzuan më 14 korrik pasi hynë në hapësirën ajrore të vendit. IRGC-ja e konfirmoi sulmin përmes një deklarate të publikuar nga agjencia iraniane e lajmeve Fars, por shtoi se ai nuk kishte për qëllim t’i dëmtonte qytetarët jordanëzë. “Ju e dini shumë



mirë se jo vetëm që nuk kemi armiqësi me vendin tuaj, por edhe ju duam - ju, popullin

fisnik, që e kuptoni dhimbjen dhe shtypjen e popullit palestinez më mirë se çdo

komb tjetër”, thuhet në deklaratën e IRGC-së. Autoritetet jordaneze thanë se nuk ka raportime për viktima nga rrëzimi i raketave. Situata në rajon u përkeqësua në fundjavë, kur ShBA-ja dhe Irani rinisën një valë të re sulmesh. Ushtria amerikane tha se goditi objektiva iraniane me synimin për ta garantuar lirinë e lundrimit në Ngushticën e Hormuzit, ndërsa Irani u kundërpërgjigj me sulme ndaj disa vendeve të Gjirit dhe anijeve në këtë rrugë ujore strategjike. Komanda Qendrore e Ushtrisë amerikane (CENTCOM) njoftoi se nga sot do ta rikthejë bllokadën detare ndaj porteve

iraniane. Sipas saj, forcat amerikane do të ndalojnë dhe kontrollojnë të gjitha anijet që hyjnë ose dalin nga portet e Iranit, ndërsa do të vazhdojnë të garantojnë lundrimin e sigurt për anijet e tjera në rajon. Ky vendim vjen një ditë pasi presidenti amerikan Donald Trump tha se ShBA-ja do të bëhet “engjëlli mbrojtës” i Ngushticës së Hormuzit - rrugë ujore strategjike ku Irani ka sulmuar ditët e fundit disa anije tregtare. Agjencia britanike për sigurinë detare, UKMTO, njoftoi se një tjetër cisternë u godit nga një raketë më 14 korrik, ndërsa po kalonte nëpër Ngushticën e Hormuzit pranë brigjeve të Omanit.

Disa të vdekur nga zjarri në Bruksel

BRUKSEL, 14 KORRIK - Disa njerëz e kanë humbur jetën në një zjarr që shpërtheu në një kantier ndërtimi në Bruksel të martën, ndërsa kërkimet për gjashtë persona të zhdukur po vazhdojnë, njoftuan

autoritetet vendase. Një numër i papërcaktuar trupash u gjetën në njërin prej dy ashensorëve të projektit të madh të rinovimit në sheshin qendror “Place de Brouckere”, ku zjarri shpërtheu herët të

martën, tha një zëdhënës i inspektoratit të punës në kryeqytetin belg. Ai shtoi se ende nuk është e qartë nëse trupat e gjetur u përkasin të gjashtë punëtorëve të raportuar si të zhdukur.

Brigada e zjarrfikësve bëri me dije se në çastin e shpërthimit të zjarrit në kantier ndodheshin më shumë se 200 punëtorë. Tre qytetarë janë dërguar në spital pas zjarrit, tha ajo.



OPOZITA: KOSOVA DUHET TË REFLEKTOJË PËR RRUGËN DREJT BE-së

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 14 KORRIK - Ish-ministri i Punëve të Jashtme, njëherësh deputet i Partisë Demokratike të Kosovës, Enver Hoxhaj, ka reaguar pas avancimit të Shqipërisë dhe Malit të Zi në procesin e integritetit evropian, duke vlerësuar se këto zhvillime duhet të shërbejnë si thirrje për reflektim për Kosovën. Në rrjete sociale, Hoxhaj uroi Shqipërinë për avancimin në negociatat e anëtarësimit me Bashkimin Evropian dhe Malin e Zi për mbylljen edhe të dy kapitujve në rrugën e tij drejt anëtarësimit. “Sot është një ditë e rëndësishme për Ballkanin. Shqipëria po avancohet në negociatat e anëtarësimit me Bashkimin Evropian, ndërsa Mali i Zi po mbyll edhe dy kapituj të tjerë në rrugën e tij drejt anëtarësimit. Urime të dy

shteteve për këtë sukses dhe për vizionin evropian që po e shndërrojnë në realitet. Për Kosovën, kjo duhet të jetë një thirrje për reflektim. Deri para 7 vitesh, vendi ynë kishte një perspektivë shumë më të besueshme evropiane dhe gëzonte një mbështetje më të madhe nga partnerët tanë. Ndërkaq, qe 3 vjet Kosova pret që statusin e vendit kandidat ta shqyrtojë dikush, por ai ka mbetur në sirtarët e Bashkimit Evropian dhe askush nuk po merret me të. Sot, ndërsa Shqipëria dhe Mali i Zi po afrohen çdo ditë e më shumë me Bashkimin Evropian, Kosova rrezikon të mbetet e fundit në rajon në rrugën drejt anëtarësimit. Kosova meriton ta rikthejë vendin e saj në agjendën evropiane dhe të ecë përpara me besueshmëri e vizion”, ka thënë Hoxhaj. Edhe ish-kryeministri Avdullah Hoti, deputet i zgjedhur i LDK-së, ka thënë se



Kosova, si vendi më proamerikan në rajon dhe më gjerë, e ka të pezulluar dialogun strategjik me ShBA-në. “Ndërsa, fqinji verior i Kosovës e nis këtë të premte raundin e parë të këtij dialogu me ShBA-në”, ka shkruar ai në “Facebook”. Hoti ka thënë se Kosova ka refuzuar të përfshihet në rrjetin rajonal të gazit, përmes të cilit synohet të shpërndahet gaz amerikan, i cili ka për qëllim uljen e varësisë nga gazi rus të vendeve të rajonin dhe më gjerë. “Në të njëjtën kohë, fqinji verior i Kosovës tashmë ka hyrë në marrëveshje të mëdha kontraktuale energjetike, përfshirë edhe importin e gazit amerikan. Nëse vazhdon kjo qasje, Kosova mbetet e izoluar ekonomikisht dhe politikisht, duke humbur mundësinë për forcimin e partneritetit strategjik dhe të sigurisë energjetike”, ka shkruar Hoti.

RUDARI: QENDRA E STUDENTËVE MIRËPRET STUDENTËT NDËRKOMBËTARË, NUMRI I TYRE PO RRITET ÇDO VIT

PRISHTINË, 14 KORRIK - Drejtori i Qendrës së Studentëve (QS), Ekrem Rudari, ka deklaruar se institucioni që ai drejton i shërben Universitetit të Prishtinës dhe zbaton çdo kërkesë që vjen nga Rektorati, duke ofruar akomodim dhe kushte edhe për studentët ndërkombëtarë që vijnë në kuadër të programeve të universitetit. Në një intervistë për “Ekonomia Online”, Rudari tha se që nga paslufta Universiteti Veror është organizuar vazhdimisht në bashkëpunim me Qendrën e Studentëve, ku studentë nga vende të ndryshme të botës qëndrojnë për dy javë. “Qendra e Studentëve i shërben Universitetit të Prishtinës dhe çdo kërkesë që vjen nga Rektorati ne e pranojmë. Kjo ndodh që nga paslufta.



Universiteti Veror organizohet vazhdimisht në bashkëpunim me Qendrën e Studentëve, ku vijnë studentë nga mbarë bota. Ata zhvillojnë një program studimor dhe qëndrojnë te ne për dy javë. Ne u ofrojmë ushqim, akomodim dhe të

gjitha kushtet që kemi në dispozicion, përfshirë edhe sallat e leximit. Më pas, ligjëratat i ndjekin në fakultete të ndryshme”, tha Rudari. Ai bëri me dije se edhe studentët e huaj që studiojnë në Universitetin e Prishtinës

akomodohen në konvikte gjatë gjithë vitit akademik dhe se, sipas tij, ata janë shprehur vazhdimisht të kënaqur me kushtet dhe mikpritjen që u ofrohet. “Studentët nga vende të ndryshme të botës që studiojnë në Universitetin e Prishtinës i pranojmë në konvikte dhe ata qëndrojnë gjatë gjithë vitit. I kemi pyetur vazhdimisht nëse janë të kënaqur, nëse u mungon diçka apo nëse kanë pasur ndonjë problem me studentët tanë. Ata janë shprehur shumë të kënaqur, sepse studentët tanë janë të sjellshëm dhe shoqëruar. E kemi traditë t’i presim mirë studentët dhe mysafirët që vijnë nga jashtë Kosovës. Ata largohen shumë të kënaqur dhe krijojnë miqësi të mira me studentët tanë”, u shpreh ai. Rudari foli edhe për procedurat e pranimit të studentëve

ndërkombëtarë dhe atyre mbarëkombëtarë në konvikte. “Edhe ata aplikojnë. Për ta nevojitet vetëm aplikimi dhe pranohen. Po ashtu, çdo vit kemi studentë mbarëkombëtarë nga Mali i Zi, Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Presheva, Medvegja dhe Bujanoci. Të gjithë këta vetëm aplikojnë dhe pranohen. Ata përfitojnë automatikisht 30 pikë”, tha ai. Sipas Rudarit, interesimi i studentëve të huaj për të studiuar në Universitetin e Prishtinës është në rritje. “Po, numri i tyre është në rritje të vazhdueshme. Vitin e kaluar kemi pasur mbi 10 studentë vetëm në Fakultetin Juridik. Kemi studentë në fakultete të ndryshme nga Spanja, Egjipti dhe shumë vende të tjera”, deklaroi Rudari.

Kurti: Trusti shënon rekord 312 milionë euro kthim bruto nga investimet në gjashtëmujorin e parë të 2026-s

PRISHTINË, 14 KORRIK - Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, ka bërë me dije se Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës (Trusti) ka shënuar rezultatin më të lartë investues në një gjashtëmujor që nga themelimi i tij. Sipas Kurtit, nga 1 janari deri më 30 qershor 2026 kthimi bruto nga investimet ka arritur në rreth 312 milionë euro. Ai theksoi se, së bashku me rezultatet e viteve paraprake, Trusti ka realizuar rreth 956 milionë euro kthim

bruto nga investimet në periudhën nga fillimi i vitit 2023 deri në fund të qershorit 2026. Sipas të dhënave të publikuara nga Kurti, kthimi bruto nga investimet ka qenë 88 milionë euro në vitin 2023, 247 milionë euro në vitin 2024, 309 milionë euro në vitin 2025 dhe 312 milionë euro vetëm në gjashtëmujorin e parë të vitit 2026.

Kurti vlerësoi se këto rezultate janë një lajm i mirë për qindra mijëra kontribuues, kursimet

pensionale të të cilëve ruhen dhe investohen për sigurinë e tyre financiare pas pensionimit. Ai shtoi se rezultatet dëshmojnë rëndësinë e qeverisjes së mirë, profesionalizmit, integritetit dhe përgjegjësisë institucionale, duke theksuar se institucionet publike përparojnë kur përgjegjësitë u besohen profesionistëve dhe interesi i qytetarëve vendoset mbi çdo interes tjetër. Në postimin e tij, Kurti përgëzoi Bordin, menaxhmentin dhe

punonjësit e Trustit për punën dhe përkushtimin e tyre, duke bërë me dije se vlera e përgjithshme e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës ka arritur në 4 miliardë e 245 milionë euro. Ai shtoi se, duke respektuar pavarësinë institucionale dhe profesionale të Trustit, institucionet do të vazhdojnë të kontribuojnë në përmirësimin e kuadrit ligjor, me qëllim që kursimet pensionale të qytetarëve të menaxhohen me



siguri, transparencë dhe perspektivë afatgjatë.



BE-ja, PRISHTINA DHE TIRANA DËNOJNË DEKLARATËN E MINISTRES SERBE PËR “SPASTRIMIN ETNIK” TË KOSOVËS

- Serbia ende nuk është çliruar nga ideologjia gjenocidale e Millosheviqit
- BE-ja duhet ta ndalë politikën anti Kosovë të Serbisë

Bashkimi Evropian (BE), institucionet e Kosovës dhe ato të Shqipërisë e kanë dënuar deklaratën e ministres serbe për Administratë Publike dhe Vetëqeverisje Lokale, Snezhana Paunović, e cila tha se, po të ishte në vend të ish-presidentit serb Slobodan Millosheviq, në vitin 1998 do ta kishte “spastruar etnikisht Kosovën”. Zëdhënësja e Komisionit Evropian, Anitta Hipper, ka theksuar se në Evropë nuk ka vend për retorikë që arsyeton ose promovon spastrimin etnik, duke theksuar se deklaratat e tilla bien ndesh edhe me zotimet që ka marrë Serbia në kuadër të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve me Kosovën të ndërmjetësuar nga BE-ja

EPOKA E RE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 14 KORRIK - Bashkimi Evropian (BE) ka dënuar deklaratën e ministres serbe për Administratë Publike dhe Vetëqeverisje Lokale, Snezhana Paunović, e cila tha se, po të ishte në vend të ish-presidentit serb Slobodan Millosheviq, në vitin 1998 do ta kishte “spastruar etnikisht Kosovën”. Zëdhënësja e Komisionit Evropian, Anitta Hipper, tha se BE-ja nuk komenton deklaratat individuale, por theksoi se në Evropë nuk ka vend për retorikë që arsyeton ose promovon

spastrimin etnik. “Deklarata të tilla bien ndesh me vlerat e dinjitetit njerëzor, pajtim, llogaridhënies dhe marrëdhënieve të mira fqinjësore mbi të cilat është ndërtuar Bashkimi Evropian”, tha Hipper duke iu adresuar gazetarëve në Bruksel. Sipas saj, ato bien ndesh edhe me zotimet që ka marrë Serbia në kuadër të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve me Kosovën të ndërmjetësuar nga BE-ja. “Ne presim që të gjithë liderët të veprojnë me përgjegjësi, të përmbahen nga retorika nxitëse dhe të kontribuojnë në krijimin e një klime besimi dhe stabiliteti

rajonat”, shtoi Hipper.


Ndaj kësaj deklarate ka reaguar edhe ministri në detyrë për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare, Andin Hoti, i cili tha se kushdo që sot bën thirrje për spastrim etnik, nuk është vetëm kërcënim për Kosovën, por dëshmi se Serbia ende nuk është çliruar nga ideologjia gjenocidale e Millosheviqit dhe nga politika kriminale që solli luftëra, masakra dhe turp historik. “Babai yt ideologjik, Millosheviq, provoi të njëjtën gjë në Kosovë. Përfundoi para drejtësisë ndërkombëtare, ndërsa Serbia u largua nga Kosova me bisht ndër shalë.

Përgjigjja e popullit të Kosovës, e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe e botës demokratike dihet. Kosova mbeti e lirë. Millosheviq përfundoi si kriminel lufte dhe sot han dhe. Të njëjtin fat do ta kishte edhe ti, dhe do ta kesh sa herë që tenton. Kushdo që sot bën thirrje për spastrim etnik nuk është vetëm kërcënim për Kosovën. Ai është dëshmi se Serbia ende nuk është çliruar nga ideologjia gjenocidale e Millosheviqit dhe nga politika kriminale që solli luftëra, masakra dhe turp historik”, ka thënë Hoti.

Edhe Daut Haradinaj ka reaguar ndaj deklaratës së ministres serbe Snezhana Paunović, duke theksuar se Kosova kurrë nuk ka qenë zemra e Serbisë. “Kosova kurrë nuk ka qenë zemra e Serbisë. Kosova ka qenë dhe mbetet fundi i Serbisë dhe kapitullimi i saj. Kjo gjuhë millosheviçiane vetëm sa e forcon vetëdijen tonë kombëtare si një komb i lirë dhe i gatshëm ta mbrojë këtë shtet dhe këtë liri nga mendësia gjenocidale, e cila shihet që është bartur brez pas

brezi. Kosova është zemra e secilit shqiptar”, ka reaguar Haradinaj në “Facebook”. Profesori Agim Zogaj në një opinion për “Epokën e re” ka thënë se BE-ja duhet ta ndalë politikën anti Kosovë të Serbisë. “A thua, zyrtarët e Parlamentit Evropian, veçmas, ata për Politikë të Jashtme të BE-së, do t’i analizojnë këto kërcënime të ministres serbe, e cila, de fakto, e bën publik qëllimin fashist të Qeverisë së Serbisë? A thua, me këtë gjuhë hegemoniste, raciste, ekspansioniste, Serbia mund t’i normalizojë marrëdhëniet me shtetin e Kosovës?! Sipas ministres Paunović, Serbia bën plane që, sërisht, në një luftë eventuale pushtuese, përmes spastrimit etnik të popullit shqiptar, t’i ‘normalizojë’ marrëdhëniet me Republikën e Kosovës! Parlamenti Evropian, meqë, e njeh fare mirë politikën e Serbisë kundër Kosovës, duhet të fillojë të veprojë diplomatikisht, dhe jo, në platformën e vetë X, të shpërndajë formulime të kota, të përgjithësuar, gjoja, për t’ia

ALBULENA HAXHIU DEKRETON ZEJNULLAH GASHIN KRYEPROKUROR TË SHTETIT



PRISHTINË, 14 KORRIK - Ushtruesja e detyrës e presidentes, Albulena Haxhiu, ka pritur të martën në takim Zejnullah Gashin, në cilit i ka dorëzuar dekretin për emërimin në detyrën e kryeprokurorit të shtetit. “Pas pranimit të propozimit dhe dokumentacionit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës, është bërë një shqyrtim i kujdesshëm dhe gjithëpërfshirës i materialeve të dorëzuara, duke përfshirë po ashtu informacionet relevante të siguruara nga institucionet kompetente të sigurisë dhe raportet e organizatave që kanë monitoruar procesin e përzgjedhjes. Marrë parasysh rëndësinë e këtij funksioni dhe nevojën për funksionalizimin e plotë të institucioneve të drejtësisë, kam vepruar në përputhje me përgjegjësitë

kushtetuese dhe ligjore. I urova z. Gashi suksese në ushtrimin e kësaj përgjegjësie të lartë shtetërore. Funksioni i Kryeprokurorit të Shtetit është një nga shtyllat kryesore të sundimit të ligjit dhe mbrojtjes së rendit kushtetues”, ka shkruar Haxhiu në “Facebook”. Ajo ka thënë se beteja kundër krimit të organizuar, korrupsionit, ndjekja e kriminelëve të luftës, dhunuesve dhe krimit të çfarëdo forme duhet të marrin përgjegje të prerë nga organi i akuzës. “Pres që Kryeprokurori Gashi, këtë detyrë ta ushtrojë me integritet të lartë profesional e moral, paanshmëri e guxim gjithnjë me përkushtim të lartë ndaj shtetit, qytetarëve, në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet e Republikës sonë”, ka thënë Haxhiu.

rikujtua pushtetit serb se, duhet t’i normalizojë marrëdhëniet me Kosovën! Serbia, ndërsa, për aq sa e di opinioni publik shqiptar, nuk merret me frazat shterpe, politike të diplomacisë konfuze, të pa vendosur të BE-së, veçmas dhe sidomos, kur është fjala për kërcënimet hegjemoniste të Serbisë ndaj Kosovës!”, ka thënë Zogaj, duke shtuar se në vazhdimësi, në lidhje me politikat e Serbisë ndaj Republikës së Kosovës, Bashkimi Evropian, institucionet e tij, kanë qëndrim moralizues, dhe jo obligues, aq më pak, konkluzione, kërkesa, kushtëzime politike ndaj udhëheqjes së Serbisë. Edhe deputeti shqiptar në Parlamentin e Serbisë, Shqip Kamberi, ka reaguar pas deklaratës të ministres të Pushtetit Lokal, Snezhana Paunović. Kamberi në rrjetin social “Facebook” ka shkruar se deklaratat fashiste të ministrave të qeverisë tregojnë më së miri se Serbia e Millosheviqit vazhdon të mbetet e njëjtë. “Për këtë arsye, sot, nëpërmjet një shkrese zyrtare, kam kërkuar reagim nga të gjitha ambasadat relevante ndërkombëtare në Beograd. Një deklaratë e tillë nuk mund të konsiderohet e izoluar. Ajo është rezultat i mohimit sistematik të krimeve të luftës, glorifikimit të kriminelëve të dënuar të luftës, relativizimit të vendimeve të gjykatave ndërkombëtare dhe revizionizmit të historisë”, ka shkruar ai. Kamberi ka thënë se për shqiptarët e Luginës së Preshevës deklaratat të tilla nga përfaqësues të institucioneve shtetërore përbëjnë një burim shtesë pasigurie. “Kur një anëtar i Qeverisë flet për spastrim etnik, pjesëtarët e komuniteteve pakicë me të drejtë shtrojnë pyetjen se çfarë sigurie mund të

presin nga këto institucione. Si vend kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian, Serbia ka obligim të respektojë dhe të mbrojë të drejtat e komuniteteve pakicë. Deklarata të tilla janë në kundërshtim të drejtpërdrejtë me këto obligime dhe tejkalojnë çdo standard demokratik mbi të cilin bazohet Bashkimi Evropian”, tha ai. Kamberi, po ashtu, shtoi se në cilësinë e deputetit në Parlamentin e Republikës së Serbisë, do ta iniciojë kërkesën për shkarkimin e ministres. Ish-ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme të Shqipërisë, deputetja Elisa Spiropali, ka reaguar pas deklaratës së ministres serbe Snezhana Paunović, e cila tha se po të ishte në vend të ish-presidentit serb Slobodan Millosheviq, do ta kishte spastruar etnikisht Kosovën. Spiropali në “Facebook” ka shkruar se është e pabesueshme të dëgjosh nga një ministre e një qeverie të një vendi që aspiron integritimin evropian të shprehë pa asnjë drojë keqardhjen se në Kosovë nuk u vranë mjaftueshëm fëmijë, gra, burra e të moshuar. “Zoti e ruajt këtë monstër që duartroket dhe glorifikon krimet. Ky nuk është mendim politik. Ky është barbarizëm verbal. Europa nuk mund ta dëgjojë këtë gjuhë dhe të heshtë. Kush justifikon ose shpreh keqardhje për krime që nuk u kryen në përmasa edhe më të mëdha, nuk mund të jetë partner i vlerave europiane, duhet të mbajë përgjegjësi politike dhe institucionale, por më së shumti humane”, ka shkruar Spiropali. Më tutje, ajo tha se Kosovës nuk ia fali kush lirinë. “Kosova lirinë e fitoi me gjak. Është në nderin dhe detyrën e Europës të mbrojë kujtesën e viktimave, që përbën themelin e parimeve mbi të cilat

është ndërtuar. Nëse Serbia rrugën drejt Bashkimit Evropian e ka seriozisht, nuk mund të qëndrojë indiferente ndaj këtij makabriteti verbal që, më së paku, e turpëron, më së shumti ia rrezikon bashkëjetesën paqësore me fqinjët”, ka shkruar Spiropali. “Një tjetër njollë turpi të neveritshme”, e ka cilësuar shefi i grupit parlamentar i Partisë Socialiste në Shqipëri, Taulant Balla, deklaratën e ministres serbe Snezhana Paunović. Balla në “Facebook” ka shkruar: “Ne shqiptarët kemi një shprehje për ujkun, por anglezët kanë një shprehje të ngjashme: ‘Leopardi nuk mund t’i ndryshojë njollat e tij’. Kjo deklaratë e një ministri serb është një tjetër njollë turpi - e neveritshme”.

Çfarë tha Paunović?

Paunović deklaroi të shtunën për televizionin serb “Kurir”, se po të ishte në vend të Millosheviqit në vitin 1998, “do ta kishte spastruar etnikisht Kosovën”, deklaratë që nxiti reagime dhe dënime edhe në Kosovë. Millosheviqi ishte president i Republikës Federale të Jugosllavisë dhe i akuzuar nga Tribunali i Hagës për krime lufte. “Kjo është deklaratat më e ashpër që kam bërë ndonjëherë në jetën time”, tha Paunović. Ajo tha se “nuk do t’i kishte likuiduar shqiptarët ashtu siç ata po përpiqen ta pastrojnë etnikisht Kosovën, por në atë mënyrë që secili që ndihej më pak qytetar i Republikës Federale të Jugosllavisë, të largohej dhe të shkonte në shtetin e vet amë”. Në një reagim të publikuar më 14 korrik, Paunović tha se nuk heq dorë nga politika e Partisë Socialiste të Serbisë - pjesë e së cilës është që nga viti 1992. “Ne jemi partia që e udhëhoqi

Serbinë në rrethana jashtëzakonisht të vështira historike, partia që bëri sakrificat më të mëdha - emri i së cilës është përmendur më së shumti në Hagë”, shkroi ajo në rrjetet sociale. Paunović është nënkryetare e Partisë Socialiste të Serbisë që nga viti 2024. Kryetari i kësaj partie, Ivica Dačić, njëherësh ministër i Brendshëm i Serbisë, i cilësoi “të turpshme dhe hipokrite” kritikant ndaj ministres. Ai tha se ata që e akuzojnë Paunovićin se “ka bërë thirrje për spastrim etnik”, tash e sa vite, “heshtin për spastrimin etnik të serbëve nga Kosova”. Zyrtarët serbë i akuzojnë shpesh autoritetet e Kosovës për dëbimin e serbëve, por pa paraqitur prova që do t’i mbështesnin këto pretendime. Gjatë luftës në Kosovë, në vitet 1998-1999, u vranë mbi 13 000 civilë, ndërsa mijëra të tjerë u zhdukën. Mbi 1 500 persona, shumica shqiptarë, vazhdojnë të figurojnë të zhdukur. Mijëra trupa u gjetën ndër vite në varreza masive në Serbi. Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë në Hagë i cilësoi drejtuesit e atëhershëm të

RFJ-së si pjesëmarrës kyçë në një “ndërmarrje të përbashkët kriminale”, që synonte dëbimin me forcë të qindra mijëra civilëve shqiptarë nga Kosova, nga marsi deri në qershor të vitit 1999. Sipas aktgjyqimeve, qëllimi ishte “ndryshimi i balancës etnike për ta ruajtur kontrollin serb mbi Kosovën”. Ish-gjenerali i Ushtrisë jugosllave, Nebojsa Pavković, si komandant i Armatës së Tretë, u dënua nga Tribunali i Hagës me 22 vjet burg për dëbime, zhvendosje me forcë, vrasje dhe përndjekje të civilëve shqiptarë në Kosovë gjatë gjysmës së parë të vitit 1999. Së bashku me të u dënuan edhe ish-shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë jugosllave, Dragolub Ojdaniq, ish-komandanti i Korpusit të Prishtinës, Vladimir Llazareviq, gjenerali i policisë Sreten Llukiq dhe ish-zëvendëskryeministri i RFJ-së, Nikolla Shainović. I akuzuari kryesor, Slobodan Millosheviq, vdiq në paraburgim para përfundimit të gjyqimit, ndërsa ish-presidenti i Serbisë, Millan Millutinović, u shpall i pafajshëm.



EDUKIMI I HERSHËM, ENDE I PAARRITSHËM PËR SHUMË FËMIJË TË PAKICAVE



PRISHTINË, 14 KORRIK - Për shumë fëmijë romë, ashkalinj dhe egjiptianë në Kosovë, pabarazia në arsim nis para se të hyjnë në klasën e parë. Aktivistët dhe ekspertët thonë se mungesa e qasjes në edukimin e hershëm ua vështirëson fillimin e shkollimit dhe mund të ndikojë në gjithë rrugëtimin e tyre arsimor. “Leximi do t’ju çojë gjithkund”, shkruan në murin e dhomës ku dhjetëra fëmijë të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian shkojnë çdo ditë. Për një të ardhme më të ndritur e shumëngjyrëshe, si dhoma në të cilën luajnë, për ta është hapur një qendër që ua ofron shërbimet e arsimit parashkollor.

Me numërorë, fleta për ngjyrosje dhe vizatim e lodra të ndryshme, ata e kalojnë çdo ditë përkrah edukatores së tyre, Xhejlane Haliti. “Kam pasur nxënës që në fillim kanë qenë shumë të ndrojtur, kanë qëndruar në qoshe dhe nuk kanë folur me askënd. Por, gradualisht, janë liruar dhe kanë filluar të bëjnë shokë e shoqe”, tregon Haliti për Radion Evropa e Lirë.

Ajo ka katër muaj që i është bashkuar organizatës The Ideas Partnership (TIP) në Fushë-Kosovë, që i ofron shërbimet e edukimit të hershëm falas për të gjithë prindërit e Lagjes 028, të banuar kryesisht me romë, ashkalinj e egjiptianë.

Vetëm për këta katër muaj Haliti thotë se ka parë se si fëmijët e moshave nga 3 deri në 5 vjeç janë zhvilluar përmes lodrave: duke vizatuar, kanë mësuar

edhe figura gjeometrike; duke ngjyrosur, kanë mësuar edhe numrat e shkronjat.

Në këtë lagje nuk ka ndonjë çerdhe tjetër, as publike e as private.

Për këtë arsye, TIP-i, më shumë se një dekadë më parë, kishte marrë përsipër që t’i ndihmonte prindërit e lagjes në edukimin e hershëm të fëmijëve të tyre. “Në fillim ne kemi shkuar te prindërit për t’i bindur që t’i regjistrojnë fëmijët e tyre. Tash vetëm përmes një lajmërimi se kur është koha e regjistrimit, ata vijnë vetë me dokumentet”, tregon për REL-in Arijeta Islami, koordinatorë e qendrës.

Interesimi, thotë ajo, është rritur sepse prindërit e kanë parë rëndësinë e edukimit të hershëm. Më pak fëmijë të tyre po braktisin shkollimin e detyrueshëm dhe më shumë po tregohen të suksesshëm kur nisin klasën e parë. Megjithatë, niveli i pjesëmarrjes së fëmijëve nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në edukimin e hershëm dhe parafillor mbetet i ulët.

Të dhënat e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës tregojnë se në të gjithë Kosovën vetëm 350 fëmijë nga këto komunitete ndjekin arsimin parashkollor, ndërsa atë parafillor edhe më pak, gjithsej 26.

Në një përgjigje për REL-in, nga Ministria thonë se niveli i ulët i pjesëmarrjes lidhet kryesisht me “gjendjen socio-ekonomike të familjeve si dhe me nivelin e ndërgjegjësimit për rëndësinë e edukimit në fëmijërinë e hershme”.

Megjithatë, për ta luftuar këtë fenomen, Ministria thotë se ka organizuar fushata informuese dhe ka nisur një program që rimbursion institucionet të cilat ofrojnë edukim dhe transport për fëmijët nga familjet që përfitojnë nga skemat e asistencës sociale.

Nga ky program deri tani kanë përfituar 55 fëmijë të këtyre komuniteteve.

Por, koordinatorja e The Ideas Partnership, Arijeta Islami, kërkon ndryshime më të mëdha. Në çerdhet publike në Kosovë kanë përparësi regjistrimi fëmijët që kanë të dy prindërit e punësuar.

Meqë niveli i punësimit në familjet e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian është i ulët, fëmijët e këtyre komuniteteve e kanë të vështirë të regjistrohen në çerdhe publike.

Ndërkohë, çerdhet private janë të papërbalueshme për shkak të çmimit nga 150 deri në 300 euro në muaj. Për këtë arsye, Islami kërkon që kriteret e pranimit në çerdhe publike të ndryshohen, në mënyra që t’u përshtaten nevojave të komuniteteve rom, ashkali e egjiptian. “Ne kemi kërkuar që t’i ndërrojnë kriteret dhe të ndërtojnë më shumë çerdhe publike në mënyrë që t’ua mundësojnë edhe këtyre fëmijëve të jenë të barabartë me të tjerët”, thotë Islami, duke shtuar se kërkesa për regjistrim është më e madhe sesa kapaciteti i tyre prej 50-60 fëmijësh.

Të dhënat e fundit të Agjencisë

së Statistikave të Kosovës tregojnë se vetëm tetë për qind e fëmijëve romë, ashkalinj e egjiptianë janë pjesë e arsimit parashkollor, ndërsa vetëm 45 për qind ndjekin arsimin parashkollor.

Dallimi me nivelin e përgjithshëm të pjesëmarrjes në vend është i ndjeshëm.

Këto statistika janë nga viti 2020, para se edukimi parashkollor të bëhej i detyrueshëm.

Anketa e njëjtë është përsëritur edhe në shtator të vitit të kaluar, por të dhënat nuk janë publikuar ende.

Eksperti i arsimit në organizatën Zëri i Romëve, Ashkalinjve dhe Egjiptianëve në Kosovë (VORAE), Bajram Ilazi, thotë se pikërisht mospjesëmarrja në edukim të hershëm thellon pabarazitë arsimore për fëmijët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian. “Kur një fëmijë nuk e ndjek arsimin parashkollor, ai humb një fazë shumë të rëndësishme të socializimit, zhvillimit të komunikimit dhe përgatitjes për shkollë”, thotë Ilazi për REL-in.

E përderisa thotë se institucionet kanë theksuar rëndësinë e luftimit të braktisjes së shkollimit, ato kanë heshtur përballë fenomenit të mosregjistrimit. “Ky është një fenomen tepër i rëndësishëm, sepse i paraprin braktisjes së shkollimit”, thotë Ilazi. Sipas tij, fëmijët e këtyre komuniteteve që nisin klasën e parë pa asnjë formë të arsimit paraprak e kanë të vështirë t’i kuptojnë rregullat e klasës, dinë më pak se nxënësit e tjerë dhe nuk dinë të

socializohen me fëmijët e tjerë.

Duke parë rëndësinë e këtij lloj arsimit, Ilazi tregon se VORAE, përmes qendrave mësimore në disa lokacione në Kosovë, ka zhvilluar fushata derë më derë për identifikimin dhe regjistrimin e fëmijëve, por shton se mungesa e financimit të qëndrueshëm mbetet një sfidë për këto iniciativa.

Por pse është shkalla e regjistrimit e ulët nëse arsimi i hershëm është kaq i rëndësishëm?

Përveç kushteve të vështira ekonomike, Ilazi thotë se këtyre komuniteteve ua vështirëson regjistrimin distanca e madhe nga shkollat e çerdhet dhe mungesa e fushatave të mjaftueshme nga institucionet arsimore. Sipas tij, shkollat dhe drejtoritë komunale të arsimit duhet të kenë rol më aktiv në identifikimin e fëmijëve që duhet të regjistrohen dhe në punën drejtpërdrejt me familjet. Ai thekson se mungesa e edukimit parafillor nuk ndikon vetëm te përgatitja e fëmijës për shkollë, por mund të krijojë një cikël që përsëritet edhe të fëmijët e tjerë në familje.

Nëse prindërit nuk e shohin pasojën e mosndjekjes së klasës parafillore te fëmija i parë, thotë ai, shpesh veprojnë njësoj edhe me fëmijët e tjerë. “Ky fëmijë ka humbur diçka shumë të rëndësishme në themelet e tij. Ndoshta me kalimin e kohës, mund ta kompensojë, por jo plotësisht si fëmijët e tjerë... Pasoja mund të jetë që edhe fëmijët e tjerë ta ndjekin të njëjtën rrugë”, përfundon Ilazi.

ILIR FERATI: FOKUSI I LDK-së MBETET FORMIMI I INSTITUCIONEVE, JO DEBATET PËR KUVEND

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 14 KORRIK - Sekretari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Ilir Ferati, ka deklaruar të martën se deri më tani nuk është deponuar asnjë nënshkrim për thirrjen e kuvendit të jashtëzakonshëm të partisë pavarësisht prej raportimeve të fundit në medie. Ferati tha se LDK-ja do ta trajtojë me seriozitet çdo kërkesë që i plotëson kriteret statutare, por theksoi se aktualisht nuk ekziston asnjë iniciativë e formalizuar brenda partisë. “Kanë qarkulluar lajme në portale të ndryshme, për të cilat nuk kam parë ndonjë burim të cituar, qoftë nga ndonjë eksponent serioz i LDK-së apo ndonjë grup serioz brenda partisë. Deri më tani nuk është deponuar asnjë nënshkrim. Në momentin kur do të ketë kërkesa nga organet e LDK-së, ato do të trajtohen me urgjencë dhe seriozitet të plotë deri në realizimin e kërkesave që i plotësojnë kushtet statutare dhe numrin e nevojshëm të delegatëve. Për momentin, nuk ka as numër të mjaftueshëm

dhe as nënshkrime të deponuara në zyrat e Lidhjes Demokratike të Kosovës”, ka deklaruar Ferati. Ai shtoi se kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, nuk u shmanget procedurave statutare dhe se ka dëshmuar vazhdimisht përkushtim ndaj demokracisë së brendshme në parti. Duke komentuar praninë e presidentes Vjosa Osmani në zyrat e LDK-së gjatë takimit të fundit me kryetarin e Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, Ferati theksoi se ajo ka qenë pjesë e listës zgjedhore të LDK-së dhe se fokusi aktual i partisë mbetet formimi i institucioneve. “LDK-ja e ka fokus të agjendës themelimin e institucioneve të Kosovës. Mendoj se kjo është tema kryesore për të gjitha palët brenda LDK-së dhe përgjigja që qytetarët e Republikës së Kosovës presin nga ne, e jo nëse po organizohet ose jo një kuvend”, u shpreh ai. Sekretari i LDK-së u bëri thirrje strukturave të partisë që debatet dhe pakënaqësitë t’i trajtojnë brenda forumeve partiake e jo në publik. “Mbledhja e nënshkrimeve është shprehje e një të drejte



demokratike të atyre që kanë bindje ndryshe. Nuk besoj se brenda LDK-së ka kryetarë degësh, deputetë apo eksponentë seriozë që dëshirojnë ta pengojnë themelimin e institucioneve të Republikës së Kosovës, pavarësisht nëse janë duke i mbledhur apo duke i kundërshtuar nënshkrimet. Si sekretar i LDK-së më mbetet t’u bëj thirrje për qetësi delegatëve

dhe kryetarëve të degëve. Kjo është pjesë e demokracisë sonë të brendshme dhe përgjegjësi e përbashkët e të gjithëve”, ka përfunduar Ferati. Ndërkaq ish-presidentja e vendit, Vjosa Osmani, nuk ka pranuar të deklarohet për zhvillimet brenda LDK-së, duke thënë se e mbështet plotësisht deklaratën e sekretarit të LDK-së, Ilir Ferati. Duke dalë nga selia e LDK-së, Osmani u pyet

nga gazetarë nëse do ta mbajë pozitën e deputetes, gjë për të cilën tha se do të deklarohet kur të vjen koha. “Është deklaruar sekretari i LDK-së. Ju lus për mirëkuptim. Më duket goxha shumë ju ka treguar, dhe është deklaruar për krejt çështjet që janë me rëndësi. E mbështes atë deklaratë në tërësinë e saj. Për të gjitha çështjet e tjera, deklarohem kur të vijë koha”, ka thënë Osmani.

KADRIJAJ: MARRËVESHJA PËR PRESIDENTIN NUK PO DUKET FARE NË HORIZONT

PRISHTINË, 14 KORRIK - Deputetja e Aleancës, Time Kadrijaj, vlerëson se vonesa në thirrjen e seancës konstituive të Kuvendit lidhet me përpjekjet e Lëvizjes Vetëvendosje për të siguruar marrëveshje politike për krijimin e institucioneve të reja. Kadrijaj tha se në të gjitha rastet e mëparshme, pas certifikimit të rezultateve zgjedhore, seanca konstituive është thirrur brenda një kohe të shkurtër, ndërsa kësaj radhe, sipas saj, nuk po shihet i njëjti ritëm. Ajo konsideron se kryeministri në detyrë, Albin Kurti, mund të jetë duke shfrytëzuar afatin maksimal kushtetues për konstituimin e Kuvendit në përpjekje për të arritur një marrëveshje politike, megjithatë thotë se deri tani nuk ka sinjale



se një gjë e tillë është afër. “Gjithmonë kur rezultatet janë certifikuar nuk ka shkuar kohë e gjatë është thirrur seanca konstituive e Kuvendit. Këtë herë, si duket, nuk e kanë

urgjencë. Ndoshta Kurti po mundohet ta shfrytëzojë afatin maksimal për konstituimin e Kuvendit. Se a do të arrihet marrëveshje për presidentin, nuk po duket fare në horizont”,

tha Kadrijaj për FrontOnline. Sipas Kadrijajt, deklaratimet e deritanishme të partive politike nuk japin shpresë për një zgjidhje të shpejtë. Ajo kujton se PDK-ja ka bërë me dije se do të mbetet në opozitë, ndërsa AAK-ja, siç thotë ajo, nuk ka kërkuar poste apo marrëveshje për interes partiak, por ka paraqitur gjashtë pika që i konsideron në interes të Kosovës dhe qytetarëve. Sa i përket LDK-së, Kadrijaj thotë se mbetet ende paqartësi, ndonëse deklaratat e fundit të Albin Kurtit dhe Lumir Abdixhikut kanë lënë të kuptohet se kontaktet dhe bisedimet mund të vazhdojnë. “E kemi parë që kryetari i PDK-së ka thënë se do të ngelen në opozitë, qëndrimet e AAK-së veç

i dimë, nuk kemi kërkuar asgjë për Aleancën, kemi kërkuar 6 pika në interes të Kosovës dhe qytetarëve të Kosovës, ndërsa me LDK-në është mbetur një mëdyshje nga deklaratat e Albin Kurtit dhe Lumir Abdixhikut se do të vazhdojnë të bisedojnë”, tha Kadrijaj. Megjithatë, ajo shpreh skepticizëm se këto përpjekje do të prodhojnë një marrëveshje, duke vlerësuar se angazhimi i deritanishëm politik ka qenë minimal dhe se gjasat për tejkalimin e ngërçit mbeten të vogla. “Se a do të arrihet marrëveshje mbetet të shihet, por duke parë një angazhim tepër minimal, mendoj se gjasat janë shumë minimale që të ketë zgjidhje për situatën e krijuar”, përfundon Kadrijaj.

Gjeneral Jashari pret ambasadorin britanik, theksohet mbështetja për zhvillimin e FSK-së

PRISHTINË, 14 KORRIK - Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjenerallejt-ënant Bashkim Jashari, ka pritur në takim delegacionin britanik të udhëhequr nga ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, Jonathan Hargreaves. Gjatë takimit gjenerali Jashari paraqiti të arriturat e FSK-së, aktivitetet, operacionet dhe planet për zhvillimin e mëtejshëm të forcës.

Ai shprehu mirënjohjen për mbështetjen e vazhdueshme që Britania e Madhe i ka dhënë FSK-së në të gjitha fazat e zhvillimit të saj. Bashkëbiseduesit diskutuan edhe për situatën aktuale të sigurisë në Kosovë, rajon dhe më gjerë, si dhe u pajtuan për thellimin e bashkëpunimit profesional në fushën e arsimit, edukimit dhe zhvillimit profesional të liderëve dhe

njësitë të FSK-së, me synim rritjen e kapaciteteve operacionale dhe profesionalizmit. Në përfundim të takimit, ambasadori Hargreaves vlerësoi leadershipin e gjeneral Jasharit në udhëheqjen e proceseve zhvillimore të FSK-së, ndërsa të dyja palët u zotuan për forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit në përballjen me sfidat e përbashkëta të sigurisë.



Statistikat e ASK-së: Rriten përdoruesit e telefonisë mobile, bien fluturimet në maj

PRISHTINË, 14 KORRIK - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar statistikat e transportit dhe telekomunikimit për muajin maj 2026. Ky publikim paraqet të dhëna statistikore me bazë mujore për transportin ajror, hekurudhor dhe telekomunikimin. Në muajin maj 2026 numri i fluturimeve të realizuara ishte 1

099 ose (-6.0 %) më pak se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, ndërsa numri i udhëtarëve në total ishte 366 360 ose (-4.0 %) më pak se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (maj 2025). Në muajin maj 2026 numri i udhëtarëve në hekurudha ishte 8 628 (1,6 %) më shumë se në periudhën e njëjtë të vitit 2025, ndërsa mallra të transportuar

përmes hekurudhës në këtë muaj ishin 182 tonë. Në muajin maj 2026 numri i përdoruesve në rrjetin e telefonisë fikse ishte 70 816 me një rritje prej 3.4 %, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, ndërsa trafiku i realizuar (në minuta) ishte 1 789 637 me një rënie prej (-4.1 %), krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të

kaluar. Në muajin maj 2026 numri i përdoruesve me parapagim (Prepaid) ishte 1 516 860 ose 2.72 % më shumë se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, ndërsa numri i përdoruesve me kontratë (Postpaid) ishte 318 946 mije ose 1.65 % më shumë se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.



AKK: KOMUNAT DO TË DËMTOHEN MBI 150 MILIONË EURO GJATË KËTIJ VITI

PRISHTINË, 14 KORRIK - Komunitet e Kosovës pritet të dëmtohen financiarisht me mbi 150 milionë euro gjatë vitit 2026 si pasojë e vendimeve gjyqësore, moszbatimit të aktgjyqimeve të Gjykatës Kushtetuese, reduktimit të grantit të arsimit dhe përgjysmimit të grantit të performancës. Kështu ka thënë drejtori ekzekutiv i Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK), Sazan Ibrahim. Ai në një intervistë për “Ekonomia Online” ka theksuar se vetëm gjatë gjashtëmujorit të parë të këtij viti komunave u janë marrë mbi 60 milionë euro nga vendimet gjyqësore, shumica prej të cilave lidhen me kontratat kolektive. “Viti 2026 është viti më i rëndë financiar për komunat e Republikës së Kosovës. Janë duke u marrë mjete financiare padrejtësisht të gjitha komunave të Republikës së Kosovës pa dallim partiak. Vetëm në gjashtëmujorin e parë të këtij viti komunave nga vendimet gjyqësore, ku shumica e tyre kanë të bëjnë me

kontratat kolektive, u janë marrë mbi 60 milionë euro”, tha ai. Ibrahim tha se një barrë tjetër financiare për komunat do të jetë edhe moszbatimi nga Ministria e Financave i aktgjyqimit të Gjykatës Kushtetuese lidhur me përvojën e punës së shërbyesve publikë. “Tani pjesa tjetër është ku ministri Hekuran Murati nuk e ka zbatuar një aktgjykim të Gjykatës Kushtetuese sa i përket normës së përvojës së punës, ku Gjykata Kushtetuese ka thënë që norma e përvojës së punës duhet të paguhet 0.5 % për vit. Kurse ministri Murati e ka zbatuar normën prej 0.25 % të përvojës së punës që nga fillimi i vitit 2023, vitin 2024, vitin 2025, për shërbyes publikë. Dhe tani, në bazë të informatave që i kemi nga niveli lokal, numrin e shërbyesve publikë në nivel lokal, dëmi i cili do t’u shkaktohet komunave apo buxheteve komunale, për shkak që ministri Murati nuk e ka zbatuar atë gjykimin e Gjykatës



Kushtetuese, do të jetë përafërsisht 60 milionë euro”, tha ai. Sipas tij, komunat do të përballen edhe me një reduktim të grantit specifik për arsim. “Shtoj kësaj edhe vendimin e fundit të Qeverisë së Republikës së Kosovës ku granti specifik për arsim ka me qenë i reduktuar për komuna rreth 24 milionë euro, ku mbi 3 000 mësimdhënës në nivel lokal do të paguhet nga buxhetet e komunave të Republikës së Kosovës dhe vlera do të jetë rreth 24 milionë euro”, tha ai. Ibrahim kritikoi edhe vendimin për përgjysmimin e grantit të performancës për komunat

përfutuese. “Ministri i Pushtetit Lokal mori vendim apo Qeveria e Republikës së Kosovës mori vendim që grantin për performancë, shumica e cila ka qenë e dedikuar në Ligjin për Ndarjet Buxhetore të vitit 2026 ka qenë 4 milionë euro. Mirëpo në mënyrë të jashtëligjshme ata e përgjysmuan këtë grant dhe vendosën që në vend të 4 milionë euro, të jetë 2 milionë euro. Domethënë dëmi ndaj pesë komunave përfutuese është rreth 2 milionë euro. Në total këtë vit, domethënë bazuar në llogaritë tona, del që komunat do të dëmtohen nga aspekti financiar mbi 86 milionë euro. I përmblodha nga të gjitha katër dëmet pothuajse kryesore të cilat niveli qendror ia ka shkaktuar nivelit lokal nga aspekti financiar”, tha ai. Ibrahim paralajmëroi se shumica e këtyre mjeteve do të merren nga investimet kapitale, subvencionet dhe mallrat e shërbimit. “Paramendoni tash, shumica absolute e këtyre mjeteve do të merren nga

investimet kapitale, nga subvencionet, nga mallrat dhe shërbimet, dhe çfarë do të mund të investojnë kryetarët e komunave në komunat e tyre përkatëse? Domethënë nëse vazhdon një trend i tillë dhe nëse vazhdon një papërgjegjësi totale e nivelit qendror kundër komunave, shumë shpejt komunat mund të shndërrohen në njësi administrative, të cilat nuk do të kenë mjete financiare për investime kapitale, për mallra, shërbime dhe subvencione, dhe do të jenë përgjegjëse vetëm për shpërndarjen e certifikatave të lindjes dhe certifikatave të tjera. Pra ky është një dëm kolosal i cili është duke iu shkaktuar komunave me qëllim dhe me vetëdije”, tha ai. Ibrahim tha se niveli qendror po bart te komunat përgjegjësi financiare që nuk burojnë nga vendimet e tyre. Ai shtoi se pasojat financiare do të rëndohen edhe nga kostot shtesë të procedurave gjyqësore dhe përmbarimore.

AUDITORJA E PËRGJITHSHME TAKOI PËRFAQËSUESIT E PROJEKTIT TË BE-së PËR MBËSHTETJEN E REFORMAVE NË MENAXHIMIN E FINANCAVE PUBLIKE



PRISHTINË, 14 KORRIK - Auditorja e përgjithshme e Republikës së Kosovë, Vlora Spanca, të martën priti në takim Neven Šprlje, ekspert i angazhuar në kuadër të projektit “Asistenca teknike për mbështetjen e zbatimit të reformave të menaxhimit të financave publike në Kosovë”, si dhe Boris Petkov, udhëheqës i ekipit të

projektit. Takimi u zhvillua në kuadër të misionit të ekspertit, i cili ka për qëllim ta mbështesë forcimin e sistemit të kontrollit dhe auditimit të brendshëm, me fokus në rolin dhe funksionimin e komiteteve të auditimit. Gjatë takimit u diskutua për praktikën e mira ndërkombëtare dhe kontributin e Zyrës Kombëtare

të Auditimit (ZKA) në avancimin e qeverisjes së mirë, llogaridhënies dhe reformave në menaxhimin e financave publike. Pjesë e takimit nga ZKA-ja ishin edhe ndihmësauditorja e përgjithshme Myrvete Gashi-Morina dhe drejtori i Departamentit të Auditimit, Arben Selimi.

Njësia A4 e Termocentralit “Kosova A” rikthehet në prodhim pas riparimit vjetor

PRISHTINË, 14 KORRIK - Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) ka njoftuar se Njësia A4 e Termocentralit “Kosova A” është rikthyer në operim pas përfundimit me sukses të riparimit të rregullt vjetor. Sipas njoftimit të KEK-ut, procesi i startimit të

njësisë ka nisur në orët e para të mëngjesit të së martës, rreth orës 01:00, ndërsa pas përfundimit të procedurave teknike dhe kontrolleve të nevojshme, njësia është sinkronizuar me rrjetin elektroenergetik rreth orës 05:15.

KEK vlerëson se rikthimi në operim i Njesisë A4 forcon kapacitetet vendore të prodhimit të energjisë elektrike dhe rrit gatishmërinë teknike të korporatës në kuadër të përgatitjeve për sezonin dimëror.

Në njoftim korporata ka falënderuar menaxhmentin, ekipet teknike, inxhinierët dhe të gjithë punonjësit e Termocentralit “Kosova A” për profesionalizmin, përkushtimin dhe angazhimin në realizimin me sukses të riparimit vjetor.



GJYKATA RRËZOI TARIFAT E TRUMP, QEVERIA AMERIKANE PAGUAN 81 MILIARDË DOLLARË RIMBURSIME

Qeveria amerikane ka shlyer tashmë dhjetëra miliarda dollarë në tarifatat që kishte vendosur përpara se Gjykata e Lartë e SHBA-së të shpallte pjesën më të madhe të taksës të paligjshme, treguan të dhënat e buxhetit të publikuara të hënën.

Tarifatat, ose taksat mbi importin e mallrave, kanë qenë një nga shtyllat kryesore të politikës ekonomike të Donald Trump që kur ai u kthye në Shtëpinë e Bardhë vitin e kaluar.

Në shkurt, Gjykata e Lartë rrëzoi një pjesë të madhe të tarifave shtesë që Trump kishte futur, duke e detyruar qeverinë t'u rimbursojë kompanitë që i paguanin ato, shkruan Guardian.

Sipas të dhënave të buxhetit, Shtetet e Bashkuara paguan një total prej 81 miliardë dollarësh në rimbursime tarifash gjatë vitit aktual fiskal, i cili filloi në tetor 2025. Në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, kjo shumë ishte vetëm pesë miliardë dollarë.

Një zyrtar i Departamentit të Thesarit të SHBA-së tha se pothuajse e gjithë rritja e pagesave ishte rezultat i vendimit të Gjykatës Supreme, me pjesën më të madhe të rimbursimeve të bëra gjatë majit dhe qershorit.

Trump i paraqiti tarifatat si një zgjidhje të përgjithshme për ekonominë amerikane, duke pretenduar se ato do të sillnin prodhimin përsëri në SHBA, do

të siguronin marrëveshje tregtare më të favorshme dhe do të zvogëlonin deficitin e buxhetit federal.

Megjithatë, deficitin buxhetor, i cili u ul pak vitin e kaluar falë të ardhurave doganore, po rritet përsëri. Në nëntë muajt e parë të vitit fiskal, ai arriti në 1.367 trilion dollarë, që përfaqëson një rritje prej dy përqind.

Në të njëjtën kohë, Shtetet e Bashkuara shpenzuan më shumë se një trilion dollarë vetëm për pagesat e interesit të borxhit kombëtar, që është 14 përqind më shumë se një vit më parë, ndërsa shpenzimet ushtarake u rritën me pesë përqind për shkak të luftës në Lindjen e Mesme.

Tarifa e përkohshme universale prej 10 përqind e vendosur nga administrata amerikane do të skadojë më 24 korrik, por Shtëpia e Bardhë po përgatit tashmë masa të reja tarifore për shkak të asaj që ajo thotë se është zbatim i pamjaftueshëm i rregulloreve kundër punës së detyruar dhe mbikapacitet në industri.

Propozimi i fundit mund të godasë partnerët kryesorë tregtarë, përfshirë Mbretërinë e Bashkuar, Japoninë, Indinë, Tajvanin dhe Kinën, dhe do t'i lejojte Trump të anashkalonte kufizimet e vendosura më parë nga gjykatat mbi politikën e tij proteksioniste. Normat e reja doganore pritet të jenë midis 10 dhe 12.5 përqind.

Shtetet e Bashkuara kanë kër-



cënuar gjithashtu të vendosin tarifa të reja prej 25 përqind për mallrat nga Brazili.

Muajin e kaluar, Trump kërcënoi gjithashtu të vendoste tarifa 100 përqind për vendet evropiane që vendosin taksa mbi kompanitë më të mëdha amerikane të teknologjisë.

Mbretëria e Bashkuar aplikon një taksë mbi shërbimet dixhitale prej dy përqind, e cila zbatohet për rrjetet kryesore sociale, motorët e kërkimit në internet dhe tregjet online. Kjo taksë, e cila paguhet nga kompani të tilla si Apple, Google dhe Amazon, solli më shumë se 800 milionë paund ose mbi 1 miliardë dollarë të ardhura gjatë vitit fiskal 2024/25, sipas Thesarit të

Mbretërisë së Bashkuar.

Franca, Spanja dhe Italia aplikojnë një taksë mbi shërbimet dixhitale prej tre përqind për kompanitë e mëdha që operojnë në tregjet e tyre, ndërsa disa vende të tjera të Bashkimit Evropian kanë prezantuar ose propozuar masa të ngjashme.

Presidenti amerikan tha se tarifa e tij do të kishte përparësi mbi të gjitha marrëveshjet tregtare me SHBA-në, "pavarësisht nëse ato kanë hyrë në fuqi, janë nënshkruar apo janë ende të planifikuara".

Në një postim në rrjetin social Truth Social, Trump shkroi: "Një numër vendesh evropiane po shqyrtojnë zbatimin e men-

jëhershëm të një takse mbi shërbimet dixhitale për kompanitë amerikane. Disa nga këto vende janë shumë afër marrjes së një vendimi të tillë. Le të shërbejë kjo deklaratë si një paralajmërim se çdo vend që vendos një taksë të tillë do të përballlet menjëherë me një tarifë prej 100 përqind për të gjitha mallrat e eksportuara në Shtetet e Bashkuara të Amerikës."

"Kjo tarifë do të ketë përparësi mbi të gjitha marrëveshjet tregtare me atë vend, pavarësisht nëse ato janë në fuqi, të nënshkruara apo jo. Nëse ata vazhdojnë me atë politikë, një tarifë prej 100 përqind do të vendoset menjëherë", shtoi presidenti i SHBA-së.

ITALIA NË ALARM TË KUQ, TEMPERATURAT PRITET TË SHKOJNË DERI NË 45°C

Një valë e re e të nxehtit ekstrem ka përfshirë Italinë dhe pjesën më të madhe të Evropës, me temperaturat që pritet të arrijnë deri në 45°C në disa zona gjatë ditëve në vijim.

Për të tretën herë brenda pak javësh, autoritetet italiane kanë shpallur alarm të kuq për disa qytete. Sot, niveli maksimal i rrezikut është në fuqi për Firencen, Peruxhian, Breshian dhe Torinon, ndërsa të mërkurën listës do t'i shtohen edhe Bolonja, Frosinone dhe Roma.

Meteorologët parashikojnë temperatura nga 39°C deri në 41°C në pjesën më të madhe të Italisë qendrore e jugore, si dhe në Sardenjë, ndërsa në zonat e brendshme termometri mund të afrohet me 45°C deri në fund të javës.

Përveç vapës ekstreme, Italia po përballlet edhe me thatësi të

të theksuar dhe mungesë të burimeve ujore, veçanërisht në rajonin e Piemontes, ku autoritetet kanë ngritur alarmin për krizën e ujit.

Temperaturat e larta kanë ndikuar edhe në jetën e përditshme. Në Firencë, korrierët e platformave të shpërndarjes së ushqimit kanë paralajmëruar grevë, duke kërkuar mbrojtje më të madhe për punën në ambiente të hapura gjatë orëve më të nxehta.

Vala e të nxehtit po prek edhe pjesën tjetër të Evropës. Në Mbretërinë e Bashkuar temperaturat mbi 30°C po favorizojnë përhapjen e zjarreve, ndërsa në Francë flakët kanë përfshirë një pjesë të madhe të pyllit Fontainebleau. Në Gjermani, autoritetet raportojnë rritje të rasteve të mbytjeve, me 99 viktima vetëm gjatë muajit qershor.



ZBULOHET MEMO-JA DRITHËRUESE E KREUT TË HAMAS PARA 7 TETORIT: IZRAELI DO NA SULMOJË ME ARMË BËRTHAMORE

Udhëheqësi i lartë i Hamasit në Gaza, Yahya Sinwar, duke folur në qytetin e Gazës, më 4 nëntor 2019.

Nga Stav LEVATON
Times of Israel

Yahya Sinwar, udhëheqësi i ndjerë i Hamasit, i cili organizoi masakrën e grupit terrorist më 7 tetor 2023, vlerësoi përpara sulmit se Izraeli mund të kundërpërgjigjej me një sulm bërthamor në Rripin e Gazës, por zgjodhi ta kryente pushimin gjithsesi, sipas një dokumenti të zbuluar rishtazi të shkruar me dorën e vetë shefit të terrorizmit.

Memoja, e shkruar në gusht 2022, u mor nga Qendra e Informacionit për Inteligjencën dhe Terrorizmin Meir Amit, dhe fragmente prej saj u botuan nga Channel 12 të dielën. Një dokument i ngjashëm u zbulua vjeshhtë e kaluar, megjithëse disa detaje nuk ishin të pranishme në raportimet e mëparshme.

Sipas Channel 12, Sinwar paraqiti plane specifike operacionale, duke përfshirë numrin e luftëtarëve që do të vendosehin në kryqëzime të veçanta, duke parashikuar 25 shkelje të njëkohshme të gardhit kufitar Izrael-Gazë, për të marrë kontrollin e 25 kryqëzimeve të ndryshme. Ai parashikoi "skuadra të trajnuara mirë" që do të kryenin secila prej këtyre depërtimit, me secilën skuadër që numëronte 100 luftëtarë.

Sinwar gjithashtu planifikoi që 2,210 luftëtarë të tjerë të sulmonin 221 komunitete të vogla në jug dhe 1,600 të tjerë për tetë më të mëdha. Ai shkroi se 1,200 luftëtarë do të vendoseshin për të sulmuar qytetet izraelite dhe 2,000 për të sulmuar bazat

ushtarake. Forca totale luftarake që ai imagjinonte do të kishte numëruar rreth 10,000 terroristë, asnjëri prej të cilëve nuk do të kishte qenë në dijeni të gjithë fushëveprimit të planit. Shifrat janë dukshëm më të larta se numri i palestinezëve që pushtuan në fakt nga Gaza më 7 tetor, të cilin Forcat Mbrojtëse të Izraelit- IDF e vlerësojnë në rreth 5,600, nga të cilët rreth 3,500 ishin luftëtarë të Hamasit, së bashku me rreth 580 luftëtarë nga grupi palestinez i Xhihadi Islamik dhe rreth 1,400 banorë të tjerë të Gazës.

"Qëllimi është të dëbohen kolonët me automjetet e tyre", shkroi shefi i terrorizmit në memo, duke iu referuar banorëve të jugut të Izraelit. Ai shkroi se "prioritet" duhet t'u jepet fëmijëve dhe grave, ndërsa urdhëroi që "burrat e moshës 17-50 vjeç të merren peng" dhe se "të gjitha telefonat duhet të merren, së bashku me çdo dokument shtesë që ata mbajnë me vete".

Raporti i Channel 12 theksoi ndërgjegjësimin e Sinwar për kostot e mundshme të sulmit, duke vënë në dukje se ai nuk shprehu siguri se Irani, i cili mbështet Hamasin, ose përfaqësuesit e tjerë rajonalë të Republikës Islamike si Hezbollahu, do të bashkoheshin në sulm, siç besohet gjerësisht se grupi terrorist shpresonte.

Për më tepër, shefi i Hamas vlerësoi se Izraeli "nuk do të hezitonte të përdorte të gjitha mjetet dhe armët në dispozicion të tij" në përgjigje të vrasjes masive, duke shtuar: "Ata madje mund të përdorin një bombë



atomike."

"Por së pari, do të befasohet nga sulmi dhe do të hyjë në kaos", shkroi ai, duke e përshkruar sulmin si "një fushatë jete a vdekjeje" dhe duke bërë thirrje për "një operacion popullor për t'u kthyer në fshatra dhe për t'i rimarrë ato simbolikisht".

Besohet gjerësisht se Izraeli zotëron armë bërthamore, por nuk e ka konfirmuar kurrë publikisht se i ka ato; nuk është palë në Traktatin e Mospërhapjes Bërthamore.

Fragmentet e publikuara rishtazi vijnë pasi Qendra e Informacionit për Inteligjencën dhe Terrorizmin Meir Amit publikoi një dokument të ngjashëm të Hamasit në tetor 2025, i cili u shkrua nga Sinwar dhe përshkruante planet për të krijuar qëllimisht "imazhe të

tmerrshme" gjatë masakrës së 7 tetorit 2023 dhe për të transmetuar drejtpërdrejt mizoritë. Mijëra terroristë të udhëhequr nga Hamasi morën pjesë në pushtimin dhe masakrat më 7 tetor 2023, duke masakruar rreth 1,200 njerëz në Izraelin jugor, kryesisht civilë, dhe duke rrëmbyer 251 njerëz, përfshirë gra, fëmijë dhe të moshuar. Terroristët kryen mizori të dokumentuara gjerësisht, duke përfshirë sulme sistematike seksuale, dhe shënjestruan hapur civilët në shtëpitë e tyre dhe në një festival muzikor në natyrë.

Një ditë pasi Hamasi nisi sulmin e tij, grupi terrorist Hezbollah në Liban sulmoi gjithashtu Izraelin duke përdorur raketa dhe dronë. Grupe të tjera të mbështetura nga Irani

në Jemen, Irak dhe Siri më vonë sulmuan gjithashtu Izraelin, dhe luftimet shkaktuan të parin nga disa konfrontime të drejtpërdrejta me Republikën Islamike.

Luftimet në Gaza u ndalën kryesisht në tetor 2025, me një marrëveshje armëpushimi të ndërmjetësuar nga SHBA-të që siguroi lirin e të gjithë pengjeve të mbetura, ndërsa Izraeli lloi pothuajse 2,000 të burgosur palestinezë. Megjithatë, përleshjet në shkallë më të vogël kanë vazhduar dhe Izraeli ende kryen sulme ajrore kundër disa objektivave të Hamasit në Gaza.


Sinwar shërbeu si udhëheqës i Hamasit në Rrip nga viti 2017 deri sa u vra nga trupat izraelite në Rafah të Gazës jugore në tetor 2024.



Palestinezët marrin kontrollin e një tanku izraelit pasi kaluan gardhin kufitar me Izraelin nga Khan Younis në Rripin jugor të Gazës më 7 tetor 2023



Komandoja e Hamasit sulmoi një bazë ushtarake pranë Kalimit Erez, më 7 tetor 2023, në pamjet e publikuara nga grupi terrorist.



**QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

Delegacioni i KFOR-it italian viziton FFK-në, Schiavone nderohet me fanellën e Kosovës

PRISHTINË, 14 KORRIK - Federatën e Futbollit të Kosovës e ka vizituar të martën një delegacion i KFOR-it italian, me të cilin FFK-ja ka ndërtuar një bashkëpunim të shkëlqyer dhe janë realizuar projekte të përbashkëta me rëndësi.

Ky delegacion i KFOR-it italian

është pritur nga anëtarë i Komitetit Ekzekutiv të FFK-së, Samir Ujkani. “Ky takim ishte njëkohësisht edhe një përshëndetje për mikun tonë, Fabio Schiavone, i cili përfundon misionin e tij në Kosovë. E falënderuam për përkushtimin, bashkëpunimin dhe miqësinë e

sinqertë, duke i bërë të ditur se FFK-ja dhe Kosova do të mbeten gjithmonë shtëpia e tij e dytë. Në shenjë mirënjohjeje dhe kujtimi për kontributin e tij, anëtarë i Komitetit Ekzekutiv të FFK-së, Samir Ujkani, i dorëzoi një fanellë të Kombëtares së Kosovës”, ka njoftuar FFK-ja.



PËRFUNDOI ME SUKSES KAMPI VEROR I TALENTEVE NGA DIASPORA, FFK-ja MIRËPRITI 135 FUTBOLLISTË DHE FUTBOLLISTE

PRISHTINË, 14 KORRIK - Federata e Futbollit të Kosovës ka përmbyllur me sukses kampin veror të talentëve nga Diaspora, projekt i cili synon identifikimin, vlerësimin dhe afrimin e futbollistëve e futbollisteve të rinj me Kombëtaret e Kosovës.

Me përfundimin e kampit treditor të gjeneratës 2011 të Kombëtares U17, është mbyllur edhe cikli 10-ditor i këtij aktiviteti, gjatë të cilit FFK-ja mirëpriti gjithsej 135 futbollistë dhe futbolliste nga vende të ndryshme të diasporës.

Në kuadër të kampit morën pjesë: 29 vajza të gjeneratave 2010, 2011 dhe 2012; 106 djem, prej tyre: 26 futbollistë të gjeneratës 2012; 43 futbollistë të gjeneratës 2011; 37 futbollistë të gjeneratës 2010.

Përgjatë gjithë kampit pjesëmarrësit u vlerësuan nga stafi teknik i FFK-së në krye me trajnerët e ekipeve të

grupmoshave të Kombëtareve U15 e U17, Ilir Nallbani, Sanije Krasniqi e Arbnor Morina, ndërsa krahas testimeve dhe stërvitjeve ata patën mundësinë të njihen nga afër me ambientin, kushtet dhe zhvillimin e futbollit në Kosovë, duke forcuar njëkohësisht lidhjen e tyre me vendin e origjinës.

Udhëheqësi i projektit, Samir Ujkani, u shpreh i kënaqur me mbarëvajtjen e kampit dhe nivelin e futbollistëve të rinj. “Sot ishte dita e fundit e kampit me talentet nga diaspora. E kemi filluar me vajzat, ku kemi pasur 29 lojtare aktive. Më pas kemi vazhduar me grupmoshat e djemve, nga gjenerata 2010 deri më 2012. Gjithçka ka shkuar shumë mirë dhe kemi parë më shumë se 100 futbollistë. Në muajin gusht do të organizohet kampi i radhës me të njëjtat grupmosha. Qëllimi ynë është të krijojmë këtë dashuri për



Kosovën, t'ua prezantojmë ambientin tonë dhe t'i motivojmë që të vazhdojnë të punojnë fort në klubet e tyre. Sa më shumë të zhvillohen ata, aq më e fortë bëhet edhe Kosova”, tha Ujkani.

Përjetimet pozitive të kampit u

ndanë edhe nga prindërit e pjesëmarrësve.

Xhevat Kurti, ish-futbollist i Kosovës, tha se për djalin e tij ishte emocion i veçantë ta vishte fanellën e Kosovës. “Ishte një përjetim shumë i mirë. Edhe vetë kam luajtur për Kosovën dhe djali im është ndier shumë mirë me fanellën e Kosovës që nga dita e parë”.

Ndërkaq Majlinda Ferati vlerësoi rëndësinë që ka ky projekt për lidhjen e fëmijëve me vendin e prindërve të tyre. “Ka qenë një ndjenjë e jashtëzakonshme që fëmijët ta njohin vendin prej nga vijnë prindërit e tyre. Kemi marrë shumë përshtypje të mira. Kemi hasur mikpritje të ngrohtë dhe djali ka krijuar shoqëri të re”, tha ajo.

Edhe futbollistët e rinj nuk e fshehën entuziazmin për përvojën e fituar.

Bijon Rashica tha: “Kemi bërë shumë shokë, kemi luajtur

futboll shumë mirë. Kam dëshirë që një ditë të luaj për Kosovën”. E Agon Hakaj u shpreh: “Kemi kaluar shumë mirë. Kam takuar shokë edhe nga Zvicra dhe jam shumë i lumtur që kam qenë pjesë e këtij kampi”.

Ndërkaq Egzon Gashi shtoi: “Kam kaluar super. Kemi krijuar shoqëri të mirë. Stafi ka qenë shumë i mirë dhe besoj se kam bërë paraqitje të mirë. Shpresoj që një ditë të arrij të luaj për Kombëtaren A të Kosovës”.

Projekti i FFK-së për talentet nga Diaspora mbetet një ndër iniciativat më të rëndësishme për identifikimin e futbollistëve të rinj me potencial dhe forcimin e lidhjes së tyre me fanellën dardane.

Kampi i radhës me të njëjtat grupmosha do të organizohet gjatë muajit gusht, duke vazhduar kështu misionin për zgjerimin e bazës së talentëve të futbollit të Kosovës.

PRESIDENTI ADEMI UDHËTON NË SHBA ME FTESË TË PRESIDENTIT TË FIFA-s, GIANNI INFANTINO



PRISHTINË, 14 KORRIK - Presidenti i FFK-së, Agim Ademi, ka udhëtuar drejt Shteteve të Bashkuara të Amerikës me ftesë të presidentit të FIFA-s, Gianni Infantino, për të marrë pjesë në aktivitetet zyrtare që organizohen në kuadër të finales së Kupës së Botës.

Gjatë qëndrimit në ShBA presidenti Ademi do t'i ndjekë nga afër dy ndeshjet gjysmëfinale, Francë - Spanjë dhe Angli - Argjentinë, si dhe finalen e madhe të turneut, e cila zhvillohet më 19 korrik në “MetLife Stadium” në Nju Jork. Po ashtu, presidenti Ademi do të

marrë pjesë në eventet madhështore të organizuara me rastin e finales së Kupës së Botës, ku do të jenë të pranishëm drejtues të federatave kombëtare, personalitete të futbollit botëror dhe mysafirë të shumtë nga e gjithë bota. Për herë të parë finalja do të

shoqërohet edhe me një spektakël të veçantë në pushimin mes dy pjesëve, në organizim të FIFA-s dhe Global Citizen.

Presidenti Ademi ishte ftuar edhe në ceremoninë hapëse dhe kishte ndjekur nga afër disa prej ndeshjeve të para të Botërorit.

Amir Shaipi kalon te Castelloni

PRISHTINË, 14 KORRIK - Portieri Amir Shaipi e ka kompletuar zyrtarisht kalimin të skuadra spanjolle CD Castellon. Pasi dështoi transferimi tek Amedspor, “gardiani” i Kosovës ka vendosur t'i bashkohet

skuadrës që garon në La Liga 2 nga Lugano. Castelloni, që ka për synim inkadrimin në elitën e futbollit spanjoll, ka paguar rreth një milion euro për ta pasur në skuadër Shaipin. “CD Castellon dhe Lugano

kanë arritur marrëveshje për transferimin e Amir Shaipit, portieri që i bashkohet skuadrës deri më 30 qershor 2030”, thuhet në komunikatë. Kjo lëvizje padyshim ka befasuar të gjithë, duke qenë se Shaipi

ka qenë i lidhur me disa klube të njohura, por në fund zgjodhi Castellonin. Portieri ka përvojë edhe në Evropë ngaqë ka përfaqësuar Luganon në 14 paraqitje në Ligën e Konferencës.



DEBAT PUBLIK

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

DEBAT PUBLIK

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.




Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë





www.facebook.com/gjejpuneshpajte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Fis Rogova nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit “Hajdar Dushi”, Gjakovë.
- Shani Shala nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e klasës; 10,11,12,13 dhe diplomën e gjimnazit “Hajdar Dushi”, Gjakovë.
- Dion Macula nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e klasës 10,11 të gjimnazit “Hajdar Dushi”, Gjakovë.
- Saranda Karakushi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e klasës 1,2,3,4 dhe diplomën e SH.M. Mjekësisë në Gjakovë.
- Bajram Krasniqi shpall të pavlefshme dëftesën nga kl, 6-9 të sh.m.u. “Rudolf Walthner” Dejnë kk Gjakovë.
- Leart Vehapi shpall të pavlefshme diplomën dhe dëftesat e shkollës së mesme të mjekësisë “Luciano Motroni” Prizren.
- Adizo SH.P.K. me nr. 812421460 bënë zvogëlim të kapitalit lëshuar nga ARBK.
- Jetmir Morina shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën e sh.m. profesionale “Gjon Nikoll Kazazi” Gjakovë.
- Vlora I. Gashi B.I. Rogovë shpall të humbur numrin unik identifikues 811865552 lëshuar nga ARBK
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906 0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

